

REPUBLIKA E SHQIPERISE
FIRMA "HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k.
Adresa: Rr Ismail Qemali L 7 Nr I3
Tel 00355 82245705
Fax 00355 82253805
CEL 00355692093738
E-mail hppfavina@yahoo.com
Web. www.favina.net
Prot. 1 NR.

Date 31. 05. 2013.

STATUTI
SHOQERISE TREGTARE
"HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k.

Bazuar ne ligjin 9901 date 14.04.2008 neni 230/2

KREU 1
DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Sipas kerkesave te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe atij nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", eshte krijuar shoqeria tregtare "HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k. e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe nenet e ketij statuti.

KREU 2
EMRI, ORTAKET, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

2.1 Emri i shoqerise:

- Emri i plote "HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k.
- Emri shkurt "HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k.
- Emri per te huajt "HIDROCENTRALI CANGONJ" sh.p.k. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar

2.2 Ortaket e shoqerise

- a) **“FAVINA 1”sh.p.k.** me NIPT K54624001I, me aksioner me 51% te kuotave te kapitalit
- b) **“FAVINA” sh.p.k.** me NIPT J64104078V, me aksioner me 49% te kuotave te kapitalit

NENI 3

Selia e shoqerise ndodhet ne fshatin CANGONJ,Komuna POJAN,Rrethi i Korces,Qarku Korce.

Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi e agjensi operative ne te gjithë territorin e Republikës se Shqiperise, dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 4

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise e saj ne perputhje me afatin e Kontrates se Koncesionit Nr. 5838 Rep. Nr.1707 Kol. date 20/05/2013 me nje afat 35 vjet.

NENI 5

Shoqeria ka vulen me emrin e saj .

KREU 3

OBJEKTI

NENI 6

Objekti i Shoqerise eshte Ndertimi,Operimi dhe Transferimi i hidrocentralit “CANGONJ”,tek Autoriteti Kontraktues,ku perfshihet financimi,ndertimi,venia ne pune,prodhimi,furnizimi,transmetimi,shperndarja,eksportimi dhe shitja e energjise elektrike ,sipas kontrates koncensionare BOT me Nr. 5838 Rep. Nr.1707 Kol. date 20/05/2013 e lidhur midis METE (Ministrise se Ekonomise Tregetise dhe Energjitikes) dhe Bashkimit te Perkohshem te shoqerive FAVINA 1 sh.p.k. dhe FAVINA sh.p.k

KAPITALI

NENI 7

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 70.000.000 (shtatedhjet milion) leke dhe perbehet nga 100 kuota me vlefte nominale 700.000 leke secila, me kontributet e ortakeve si me poshte:

1. **"FAVINA 1" sh.p.k.** 35.700.000 leke, 51 kuota ose 51% te kapitalit , numri i votave 51.
2. **"FAVINA" sh.p.k.** 34.300.000 leke, 49 kuota ose 49% te kapitalit , numri i votave 49.

Kapitali themeltar do te shlyhet brenda afatit te perfundimit te ndertimit te vepres. Burimi kryesor do te jete kredia bankare qe do merret per kete qellim dhe mjetet e lira te kompanise.

Ndryshimet e kuotave mund te arrihen nepermjet kontributeve ne kapitalin e shoqerise ose me shitblerje.

NENI 8

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te ortakeve, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 9

Ortaku mund te shese te treteve kuotat e tij te kapitalit pjeserisht ose teresisht. Shitja e kuotave tek te tretet do te behet vetem pasi te kete marre vendim asambleja e ortakeve me shumice absolute te votave.

NENI 10

Kapitali i shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros,detyrimet e ortakeve huara dhe instrument ate tjera,dhe te tjera pasuri te nevojshme te luajteshme apo te paluajteshme per ushtrimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 11

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.

KREU 4

ORGANET DREJTUESE

NENI 12

Organet drejtuese te shoqerise do te jene:

- Asambleja e ortakeve
- Administratori

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte.

ASAMBLEJA

NENI 13

Asambleja e Ortakeve eshte organi me i larte vendimor. Asambleja e Ortakeve merr vendime sa here e sheh te arsyeshme, por domosdoshmerisht per te

miratuar bilancin vjetor te shoqerise, per percaktimin e politikave tregtare, per ndryshimin e statutit (me $\frac{3}{4}$ e votave), emerimin ose shkarkimin e administratoreve, emerimin ose shkarkimin e likujduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar, zmadhimin ose zvoglimin e kapitalit, perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe procedimet e tjera ndaj administratoreve, riorganizimin ose prishjen e shoqerise. Te gjitha vendimet duhet te regjistrohen ne nje liber te vecante te vendimeve. Vendimet e paregjistruara jane te pavlefshme.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 14

Administrator i shoqerise emerohet Z. Adnan Qylafi. Zgjatja e afatit te administratorit do te jete 5 vjet nga dita e rregullimit te statutit..

NENI 15

Administratori ka te drejte te perfaqesoj shoqerine ne maredhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 6 te ketij statuti.

Organi Administrativ (administratori) eshte kompetent per te:

- miratuar planet dhe bilancet periodike mujore dhe tremujore;
- vendosur strukturen e aparatit te shoqerise;
- marre ne pune persona te ndryshem dhe rregullimin e maredhenieve te punes me ta;
- vendosur rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve te ndryshme (te vecanta), etj;
- perfaqesuar apo emeruar perfaqesues ne ceshtje gjyqesore qe mund te kete shoqeria;
- perfaqesuar shoqerine ne regjistrin e prones sipas nenit 20 te ketij statuti.

KREU 5

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 16

Shoqeria eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurise se saj. Ajo vepron ne regjistrin e prones si cdo person tjeter juridik ne Shqiperi; mund te bleje, te shese, te jape ne perdorim, te ngarkoje me barre per detyrime ndaj te treteve ose per kredi bankare, etj.

NENI 17

Shoqeria ka llogarine e saj rrjedhese, si dhe librin e saj te llogarive ne baze te kerkesave te ligjit per kontabilitetin e dispozitave te tjera fiskale.

Transferimi i mjeteve monetare dhe transakcionet financiare do te kryhen ne baze te kriterëve te caktuara nga Banka e Shqiperise.

NENI 18

Veprimet ekonomiko-financiare te shoqerise nisin; vitin e pare ne momentin e rregjistrimit ne QKR dhe ne organet tatimore e mbyllen ne 31 dhjetor te po atij viti, ndersa vite te tjera ne 1 Janar dhe mbyllen ne 31 Dhjetor te cdo viti. Ne fund te cdo periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve ne fuqi. Bilancet periodike (mujore, tremujore, gjashtemujore) miratohen e nenshkruhen nga administratori i shoqerise. Bilancet vjetore miratohen nga asambleja e ortakeve e nenshkruhen nga administratori dhe depozitohen ne QKR e ne Tatim Taksa.

NENI 19

Fitimi neto i realizuar, pasi jane zbritur rezervat ligjore deri 5% te fitimit te cilat do te krijohen ne shoqeri deri shumen 10% te kapitalit dhe tatimet mbi fitimin, mbetet ne perdorim ortakeve te cilet vendosin per perdorimin e tij.

KREU 6

MAREDHENIET E PUNES

NENI 20

Maredheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne kete statut do zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne Republiken e Shqiperise. Mosmarreveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert zgjidhja behet ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj, nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

KREU 7

DISPOZITA TE VECANTA

NENI 21

Veprimtaria e shoqerise pushon me vendim te asamblese se ortakeve te shoqerise per shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakeve.
- riorganizohet ne nje forme tjeter.

NENI 22

Ne kushtet e nenit 23 te ketij statuti, Asambleja e Ortakeve cakton nje ose me shume likuidatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer te gjitha veprimet e likuidimit te saj, duke likuiduar ne radhe te pare detyrimet ndaj punonjesve, shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakeve. Ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit, Asambleja e Ortakeve eshte e detyruar te derdhe kuotat e tij deri ne nivelin e kuotave te kapitalit themeltar.

NENI 23

Mosmarreveshjet qe mund te lindin ne shoqeri me te tretet, zgjidhen me pajtim, ne te kundert palet i drejtohen Gjykates per zgjidhje.

DISPOZITA TE FUNDIT

NENI 24

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit themelimit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, Tirane, ne baze te ligjit nr.9723 date 03.05.2007.

NENI 25

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te bejne Asambleja e Ortakeve si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti.

Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxirret vete statuti.

NENI 26


Ky statut u perpilua ne Asambleja e Ortakeve duke shprehur vullnetin e tyre te plote e te lire.

Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarta secila per t'u depozituar ne QKR e per t'u shperndare ne organet kompetente dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

Korce me 31.05.2013

Asambleja e Ortakeve

"FAVINA 1" sh.p.k.



"FAVINA" sh.p.k.

61 Page